



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS**  
OSNOVNI SUD U MITROVICU – BASIC COURT OF MITROVICA

**C.nr.174/2012**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, (e vendosur ne objektin e Degës së kësaj Gjykate në Vushtrri), si kontestimore e përbërë nga gjyqtari individual **Faton Ademi**, me procesmbajtësen Elheme Peci në çështjen juridike të paditësit: \_\_\_\_\_ nga Mitrovica të cilin sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Av. \_\_\_\_\_ nga Mitrovica, kundër të paditurës: \_\_\_\_\_ nga Mitrovica, tani me vendbanim të panjohur të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm Av. \_\_\_\_\_ nga Mitrovica, baza e kontestit: Pronësi, me datën 05.05.2014 bie këtë:

**A K T G J Y K I M**

- **VËRTETOHET** se paditësi \_\_\_\_\_ nga Mitrovica është pronar mbi bazën e mbajtjes me mirëbesim, në parcelën kadastrave Nr.P-\_\_\_\_\_ ZK-Mitrovicë në sipërfaqe të tërësishme prej 257 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur Kosovska.
- **OBLIGOHET** e paditura qe brenda afatit 15 ditor pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi t'ia lejojë paditësit që paluajtshmërin e cekur në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi ta regjistroj në regjistrat kadastral , pranë Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Mitrovicë, në të kundërtën ky aktgjykim do të shërben si bazë për paditësin që paluajtshmërin në fjalë ta regjistroj në Kadastër, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.
- **OBLIGOHET** paditësi që në emër të shpenzimeve gjyqësore për përpilimin e aktgjykimit t'ia paguaj gjykatës shumën prej 20 euro në afat 15 ditor pas plotfuqishmërisë së të njëjtit nën kërcënimin e ekzekutimit të detyrueshëm.

## A r s y e t i m

Paditësi me datë: 09.08.2012 ka parashtruar në gjykatë padi me anë të së cilës ka kërkuar nga gjykata që të vërtetohet se është pronar i palujtshmëris e cila evidentohet në fletën poseduese nr. UL-71208072-01172 ZK-Mitrovicë në sipërfaqe prej 257 m<sup>2</sup> që udhëhiqet në emër të të paditurës.

Në fjalën përfundimtare, i autorizuari i paditësit deklaroi: Se nga shqyrimi i sotëm kryesor dhe nxjerrja e provave si dhe duke dëgjuar dëshmitaret, vërtetohet se paditësi nga Mitrovica në vitin 1978 ka bler paluajtshmërin nga zonja në shumë prej 8.000 dinar të atëhershëm, të cilën shumë ja ka paguar në tersi të paditurës, dhe qe nga ajo kohë është shfrytëzues me mirëbesim i kësaj paluajtshmërije, kështu që kanë kaluar më shumë se 20 vite nga themelimi i posedimit, dhe qe nga ajo kohë nuk ka qenë i penguar nga askush, andaj në pajtim me nenin 40 par.1 të Ligjit mbi Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore i propozoj gjykatës qe ta aprovoi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar.

Pasi që e paditura nuk ishte gjendur në adresën e dhënë, gjykata me propozim të palës paditëse të njëjtës konform dispozitave ligjore të LPK-së i'a caktoi përfaqësuesin e përkohshëm nga radha e avokatëve.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurës në fjalën përfundimtare deklaroi: Pas administrimit të provave dhe dëgjimit të dëshmitarëve në këtë qeshje pronësore-juridike vërtetohet fakti se paditësi me mirëbesim e ka mbajtur pronën lëndore me tepër se 20 vite, dhe është e pakontestueshme fakti se konform dispozitave të nenit 40 par.1 të Ligjit mbi Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, e ka fituar të drejtën e porosis, mirëpo për hir të së vërtetës në këtë ras ja lë në dispozicion gjykatës qe në mënyrë meritore te vendos për këtë qeshje.

Gjykata në procedurën e provave administroj këto prova: Certifikata mbi te drejtën e pronësisë me nr.UL- fatura e tatimit në pronë e datës 30.07.2012, kopja e letërnjoftimit te paditësit, dëshmia e dëshmitareve dhe

Gjykata provat e administruara i vlerësoj konform neneve 7 dhe 8 të LPK-së, dhe pas vlerësimeve arriti në këto përfundime:

Nuk është kontestuese se paditësi menjëherë pas blerjes ka hyrë ne pushtet faktik të parcelës kontestuese dhe të njëjtën e shfrytëzon pa ndërpërre si dhe rregullisht i ka kryer obligimet e pagesës së tatimit në

pronë, kjo vërtetohet në bazë të faturës së tatimit në pronë, si dhe dëshmisë se dëshmitarit Skender Ibrahimini

Po ashtu nuk është kontestuese qe paditësi Iljaz Spahija është shfrytëzues dhe posedues i papenguar nga askush i palujtshmëris - parcelës kadastrale P-<sup>1</sup> në sipërfaqe prej 257 m<sup>2</sup>, pasiqe asnijëherë nuk ka pasur asnijë pengës nga askush e po ashtu asnijë pretendim në lidhje me pronën në fjalë, një gjë të tillë e vërteton edhe dëshmia e dëshmitarit ku i njëjti deklaron se paditësi paluajtshmërine e ka blerë në vitin 1978 , në vlerë prej 8.000 dinarëve të atëhershëm kjo shitblerje është bërë në formë gojore dhe nuk ka qenë i penguar asnijëherë nga askush, po ashtu gjykata me rastin e vendosjes mori për bazë edhe dëshminë e dëshmitares

ku e njëjta deklaroj se unë kam banuar në atë shtëpi prej viti 2006 deri në vitin 2010, ne bazë të raporteve familjare qe i kem me paditësin e di qe paditësi e ka blerë këtë pronë dhe nuk ka qen i penguar nga askush asnjëherë.

Gjykata i mori për bazë dëshmitë e dëshmitarëve pasi që ishin në përputhje me shkresat tjera të lëndës.

Prandaj, gjykata nga provat e cekura më lartë si dhe gjendjen e vërtetuar faktike si dhe nga faktet jokontestuese, konstatoi se paditësi në bazë të nenit 28 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Pronësorë-Juridike të vitit 1980, ka fituar të drejtën e pronësisë mbi parcelën e cekur në pikën I. të dispozitivit mbi bazën e mbajtjes me mirëbesim. Edhe Ligji mbi Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, ligji nr.03/L-154, nen 40 par.1 ka paraparë fitimin e pronësisë me mirëbesim nëse kanë kaluar 20 vjet ne posedim te pa ndërprere.

Gjykata lidhur me vendosjen mbi shpenzimet procedurale, u bazua në nenin 450 të LPK-së, pasi qe paditësi nuk i kërkoj shpenzimet e procedurës, prandaj vlerësoj qe secila palë i bartë shpenzimet e veta te shkaktuara me veprimet e tyre, ndërsa për shpenzimet gjyqësore u bazua në nenin 10.12 në lidhje me nenin 10.1 te Udhëzimit Administrativ të KGJK-së për unifikim te Taksave Gjyqësore nr.2008/2.

Andaj, gjykata konform nenit 143 të LPK-së vendosi si në diapositiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË,  
C.nr.174/2012 me dt. 05.05.2014**

**G J Y Q T A R I ,  
Faton Ademi**

**UDHËZIM PËR MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat 15 ditorë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet kësaj gjykate.